



Planuar / Dituruar Punëpunë/Prostatë Received/Delivered	16.05.2022	2	viti god year
Organ / Tipi i Organ / Admita Org / Unit	Nr. Prot Pr. Prot Prot No	Shtesa Protok Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTICK	2843/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.417/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.417/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në kundër organit të punësimit Agjencia për Barazi Gjinore në çështjen juridike “masë disiplinore-vërejtje”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 16.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.417/2022 e datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet masa disiplinore “vërejtje” e shqiptuar ndaj ankuesit nga Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi përmes shkresës me numër referencë 103/2022 të datës 22.03.2022.
- III. Obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Barazi Gjinore, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil si dhe regjistri përkatës masën disiplinore sipas pikës 2 (II).
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë për Barazi Gjinore, më datë 26.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 2365/2022, kundër masës disiplinore “vërejtje” e shqiptuar ndaj ankuesit nga

Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi përmes shkresës me numër referencë 103/2022 të datës 22.03.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Agjencinë për Barazi Gjinore. Ndërsa Këshilli më datë 10.05.2022 ka pranuar dokumentacionin lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e me numër protokoli 2365/2022 të datës 26.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Masën disiplinore "vërejtje" me numër referencë 103/2022 e datës 22.03.2022 të shqiptuar nga Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore, ndaj ankuesit; Shkresën për takim me rastin e shënimit të 8 marsit e datës 08.03.2022; Shkresën me titull trajnim për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje datës 17.03.2022, 18.03.2022; Zarfin e datës 21.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 29.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 10.05.2022; Vërejtje e datës 02.11.2020 e shqiptuar ndaj ankuesit nga Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore; Emailin e datës 02.11.2020 nga ankuesi për Emilin e datës 26.10.2022 nga Agjendën e trajnimit për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje 17-18.03.2022; Akt Emërimit Nr.prot:215/2011 i datës 24.10.2011 në emër të ankuesit; Deklaratën Nr. ref.184/2022 e datës 10.05.2022; Deklaratën Nr. ref.183/2022 e datës 10.05.2022; Deklaratën Nr. ref.182/2022 e datës 10.05.2022; Deklaratën Nr. ref.185/2022 e datës 10.05.2022; Ftesë për trajnim dy ditore me temën Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga dhuna në familje; Emailin e datës 27.11.2019 nga Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Legjislacion; Raportin i prezencës në punës për datën 23.03.2022 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin i datës 26.01.2021 dhe 31.01.2022; Shkresë për thirrje telefonike; Emaili i datës 10.05.2022 nga ankuesi; Emaillet e datës 22.03.2022 nga për Emailin e datës 22.03.2022 nga për dhe ankuesin; Emailin e datës 18.03.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 22.03.2022 nga për ankuesin dhe Raporti i hyrje daljeve i datës 22.03.2022 për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së është e bazuar ankesa e ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës respektivisht sipas Akt Emërimit me numër protokoli 215/2011 të datës 24.10.2011, rezulton së ankuesi është i emëruar në pozitën *Zyrtar i Lartë për Legjislacion* në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit pranë Agjencisë për Barazi Gjinore. Ndaj të njëjtit Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore përmes shkresës me numër reference 103/2022 të datës 22.03.2022 ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", për shkak të mungesës së përgjegjësisë dhe mungesës në vendin e punës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon që masa nuk i përmban elementet formale të aktit administrativ sipas Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative; kjo masë është shqiptuar nga personi jo kompetent për arsye që Kryeshefja Ekzekutive nuk është mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë

e ankuesit kështu që ka ndërhyrë direkt në kompetencat e mbikëqyrësit të drejtpërdrejt në kundërshtim me Ligjin për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht kapitullin IV, lidhur me Disiplinën në Shërbim Civilë, si dhe Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, me të cilën është rregulluar në mënyrë specifike procedura dhe masat disiplinore për nëpunësit civil. Ndërsa në kuptim të kompetencës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore, Kolegji ju referua nenit 47 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është përcaktuar se: *1.Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil, ndërlidhur me këtë neni 48 paragrafi 1 i po këtij ligji ka përcaktuar se: 1.Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë”, e mbi këtë bazë ligjore rrjedh se Kryeshefja Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore “vërejtje”, sepse në bazë të provave materiale lidhur me çështjen në procedurë përkatësisht sipas Akt emërimit të ankuesit, përshkrimit të detyrave të punës si dhe formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit është Udhëheqësi i Divizionit për Legjislacion, andaj nisur nga ky konstatim rrjedhë së është i bazuar pretendimi ankimor i ankuesit mbi këtë bazë.*

Meqenëse një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm sipas nenit 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nuk u lëshua në konstatimet e ligjshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.417/2022

Avdy BEKTESHI

Zyrtar për bashkëpunim profesional/procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Barazi Gjinore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

